



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr. 482 Prot

Vlorë, më 03.04.2024

VENDIM

Nr. 4, datë 26.03.2024

PROPOZIM PËR DHËNIE SHITESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 26.03.2024 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, nenit 5 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, pikës 4 dhe 5 të VKM - së Nr. 429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar, si dhe kërkesës së Z. Moisi Fuat Dalipaj për përfitim shtese pensioni të posaçëm shtetëror, protokolluar me tonën Nr. 182 Prot, datë 05.02.2024,

VENDOSI;

1. T'i propozojë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhënien e shtesës së Pensionit të Posaçëm Shtetëror Zotit Moisi Fuat Dalipaj, për kontributin shumëvjeçar në fushën e gazetarisë së shkruar dhe asaj radiofonike sportive, duke treguar shembull të lartë profesionalizmi dhe qytetarie.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Sektori i Urbanistikës, Zhvillimit të Territorit, Burimeve Njerëzore, Arsimit, Kulturës, Turizmit dhe Çështjeve Sociale në Këshillin e Qarkut Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ervis Moçka

Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë Nr. _____ Prot, datë _____.2024

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria", Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

RELACION

Të Nderuar Këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe pikës 4 e 5 të VKM - së Nr. 429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar, Pensionin e Posaçëm Shtetëror e përfitojnë ata persona që:

- a) Kanë marrë pjesë në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, në lëvizjet popullore, në luftën kundër pushtuesve nazifashistë brenda dhe jashtë Shqipërisë, në mbrojtjen e kufirit e ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë, në lëvizjen demokratike dhe që kanë merita të veçanta;
- b) Kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës;
- c) Kanë vuajtur nga persekutimi politik nën regjimin komunist.

Pensionin e Posaçëm Shtetëror e përfitojnë personat të cilët përmbushin kushtet e sipërpërmendura si shtesë mbi pensionin që u takon nga Sigurimet Shoqërore, ose si pension nëse nuk përfitojnë pension nga Sigurimet Shoqërore.

Në mbështetje të bazës ligjore të sipërpërmendur z. Moisi Dalipaj, i lindur më 25.06.1956 në qytetin e Vlorës dhe banues në Vlorë ka paraqitur kërkesë pranë institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë për përfitim shtesë Pensioni të Posaçëm Shtetëror, protokolluar me tonën Nr. 182 Prot, datë 05.02.2024.

Kërkesa drejtuar institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë mbështetet në punën e palodhur dhe aktivitetin profesional e dinjitoz si gazetar për të përcjellë te dëgjuesit, lexuesit dhe shikuesit, dashamirësit e sportit, veprimtaritë më të rëndësishme sportive të qytetit të Vlorës dhe jo vetëm.

Zoti Dalipaj përveç profesionit të tij si Financier i lartë pranë Albpetrol sh.a, paralelisht për më tepër se 35 vjet ka dhënë kontributin e tij si gazetar dhe komentator sportiv në "Radio Tirana", në shtypin sportiv nga viti 1978 e në vazhdim në gazetën "Sporti Popullor", "Sporti", "Sport Express" dhe Gazeta "Telegraf" etj.

Autor i 1320 kronikave sportive për Radio Tiranën dhe 25 dokumentar sportiv për figurat e sportit vlonjat në vite. Ka përvojë si moderator i aktiviteteve sportive në nivel kombëtar dhe është i angazhuar vazhdimisht nga Radio Tirana në transmetimet e ekipit tonë përfaqësues, finalët e kampionateve europiane dhe botërore. Në vitin 1998 z. Dalipaj është pranuar si anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare të Gazetarëve Sportivë A.I.P.S si dhe anëtar i Unionit të Gazetarëve të Shqipërisë. Përveç zërit të tij karakteristik dhe të dallueshëm lehtësisht edhe për emocionet që transmeton gjatë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

aktiviteteve sportive ai është autor i mbi 8 mijë artikujve sportive dhe librit “Yje në fushën time”, në kuadër të 100 vjetorit të Klubit Sportiv Flamurtari.

Bashkëlidhur kërkesës gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:

- Jetëshkrimi;
- Çertifikatë personale, me datë 15.01.2024;
- Çertifikatë familjare, me datë 15.01.2024;
- Fotokopje letërnjoftimi elektronik;
- Vërtetim për lloj dhe masë pensioni nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, më datë 15.01.2024;
- Kopje e çmimit “Petro Marko” dhënë nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, me motivacion “Për kontributin e dhënë në media dhe jetën publike”;
- Kopje e çmimit kombëtar “Anton Mazreku” për Gazetarinë Sportive, si radiokronist i qytetit të Vlorës, i cili përmes mikrofonit në 25 vjet pasqyron me pasion e kompetencë ecurinë dhe zhvillimet e futbollit shqiptar dhe atij vlonjat;
- Kopje e Titullit “Mjeshtër i Madh” dhënë nga Presidenti i Republikës me Nr. Dekreti 13131, datë 01.07.2021 me motivacion “Me mirënjohje ndaj kontributit dhe vlerave të spikatura në pasqyrimin e veprimtarive sportive, si dhe për promovimin e figurave të shquara të sportit vlonjat dhe atij kombëtar, duke u dalluar si komentator sportiv i rrallë në “Radio Tirana”;
- Kopje e Titullit “Naim Frashëri” dhënë nga Presidenti i Republikës me Nr. Dekreti 10036, datë 24.02.2017 me motivacion “Për kontributit shumëvjeçar të dhënë në fushën e gazetarisë së shkruar dhe asaj radiofonike sportive, duke treguar një shembull të lartë profesionalizmi dhe qytetarie”;
- Kopje e Titullit “Mirënjohje e qytetit të Vlorës” dhënë nga bashkia Vlorë, më datë 02.05.2015 me motivacion “Gazetar profesionist i gazetarisë sportive për 35 vjet, intelektual me kontribute të çmuara në publicistikë dhe edukimin e brezave me vlerat më të mira të sportit vlonjat dhe atij kombëtar”;
- Kopje e Titullit “Mirënjohje” dhënë nga Komuna Gjakovë, më qershor 2012, me motivacionin “Për pjesëmarrje në Turnirin e dytë Mbarkombëtar Liburni 2012”.
Duke u bazuar në kërkesën e z. Moisi Dalipaj, në zbatim të Ligjit Nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të pikës 4 dhe 5 të VKM- së Nr. 429 datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” i ndryshuar, mendojmë se kërkuksi plotëson kushtet për të përfituar këtë lloj pensioni.

Jurist

Alma Myrtaj

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria”, Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov
Tel: +355 33 421 600